



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM

Nr 22 Datë 10.05.2007

PER
**DHËNIE TITULLI "QYTETAR NDERI" I QYTETIT TË KORÇËS
PERSONALITETIT DHE REGJIZORIT TË KINEMATOGRAFISË SHQIPTARE
Z.VIKTOR GJIKA "ARTIST I POPULLIT"**

Këshilli i Bashkisë së qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Kulturës për « DHËNIE TITULLI "QYTETAR NDERI" I QYTETIT TË KORÇËS PERSONALITETIT DHE REGJIZORIT TË KINEMATOGRAFISË SHQIPTARE Z.VIKTOR GJIKA "ARTIST I POPULLIT", bazuar në ligjin nr. 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32, si dhe V.K.B. nr 8 dt.07.02.2005 "Dhënie titullit "stimuj nderi" » mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e titullit « Qytetar Nderi » i qytetit të Korçës, personalitetit dhe regjizorit të kinematografisë shqiptare Z. Viktor Gjika «Artist i Popullit», me motivacion: **Për merita të shquara, në fushën e kinematografisë shqiptare duke krijuar vepra që kanë lënë gjurmë të shquara në fondin e artë të kulturës kombëtare.**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Kulturës i Bashkisë
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Rajmonda Nase